



INSTITUCIONET E PËRKOHSHMEVETËQEVERISËSË TË KOSOVËS



Qeveria e Kosovës  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

## Raport sektorial

Raporti i zhvillimit hapësinor për sektorin e

# TURIZMIT

Prishtinë, shtator 2004



Draft / dokument pune  
Raport i sektorial i zhvillimit hapësinor për sektorin e turizmit

# Zhvillimi i turizmit dhe programi i rregullimit hapësinor të turizmit

Hartues të draftit / dokumentit punues

Halil Bajrami, Drejtor i DT, MTI  
Kolë Staka, Këshilltar në MTI, MTI  
Zana Mehmeti, hulumtues profesional, MMPH-IPH  
Kadrush Cani, ekonomist, MMPH, DPH

Prishtinë, shtator 2004



## HYRJE

Turizmi është një nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne. Në vendet e zhvilluara, por edhe në disa shtete në tranzicion, është produkt i rëndësishëm eksporti dhe gjenerator i punësimit. Përfshinë një gërshetim të gjerë dukurish dhe raportesh që lindin gjatë kohës së udhëtimit turistik, ndërsa në realizimin e tij futet thellë jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në aspektin ekologjik, social dhe kulturor të jetës.

Edhe në Kosovë turizmi është degë e rëndësishme ekonomike. Industria Turistike e Kosovës ka realizuar 8-10% të produktit shoqëror vendor, varësisht nga fakti për cilin vit është fjala dhe a janë marrë parasysh të gjithë faktorët e drejtpërdrejtë (industria hoteliere, gastronomia) ose faktorët indirekt (bujqësia, ndërtimtaria, etj.)

Këto të dhëna, megjithatë, kanë vetëm vlerë relative. Pjesëmarrja e madhe në produktin shoqëror vendor mund të shpjegohet vetëm me dobësinë e sektorëve të tjerë ekonomik. Pjesëmarrja e madhe e ekonomisë turistike në produktin shoqëror vendor zbulon, në radhë të pare, dobësitë e sektorëve të tjerë të ekonomisë ndërsa potenciali turistik as që është është shfrytëzuar sa duhet. Kjo pjesëmarrje në numra absolut dhe relacioni me produktin shoqëror vendor mund të jetë edhe më e madhe, në qoftë se oferta turistike përparon në aspektin cilësor dhe sasior.

Zhvillimi intensiv, dhe në masë të madhe spontan dhe i pa kontrolluar i hotelerisë pasluftë, shoqërohet me pasoja disekuilibruese për mjedisin dhe territorin. Këto pasoja janë të dëmshme për interesat e dy grupeve: banorë vendas dhe operatorët turistikë përkatës.

Për grupin e parë këto pasoja shoqërohen me një përdorim të pakthyeshem të të mirave publike dhe të vështira për t'u kthyer në gjendjen e mëparshme. Ndërsa për të dytin, i njëjti kërcënim pengon efikasitetin e ardhshëm të investimeve në ato vende, lokacionin etj.

Andaj, planifikimi cilësor i hapësirës është një ndër parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të turizmit në Kosovë.

## PIKËNISJA E TURIZMIT NË KOSOVË NË VITET 2000-2004 DHE SYNIMET E ZHVILLIMIT

Shikuar nga aspekti turistik Kosova është vend në zhvillim. Pas 10 vjet ngecjeje në zhvillim dhe në izolim në periudhën 1989-1999, shkatërrimeve gjatë luftës së viteve 1997-1999, pas luftës vendi duhet të zgjidhte detyra komplekse: oferta e tij duhet të përcjellë zhvillimin ndërkombëtar, përsëri duhet ta definojë pozitën e vet, t'i rritë të hyrat, ta ruajë potencialin dhe resurset. Njëkohësisht duhet ta zbatojë procesin e vështirë të transformimit në të gjithë segmentet e ekonomisë dhe të jetës.

Kjo detyrë vështirësohet, sepse tregjet ndryshojnë. Të gjitha destinacionet në rajon dhe më gjerë i pret një konkurrencë më e forte dhe luftë e ashpër për pjesën e tyre në treg. Kështu e përmirësojnë cilësinë e hoteleve, të shërbimeve dhe të infrastrukturës. Tregjet diversifikohen dhe rishfaqen duke u kapur për trashëgiminë kulturore-historike dhe kujdesen për të.

Pozita e Kosovës është e dobët: mungojnë mjetet financiare, produkti i përshtatshëm për tregun dhe personeli profesionalisht i kualifikuar.

Ofertat janë të orientuara gati vetëm në tregun që ka mundësi të vogla pagimi (low-Budget). Edhe më tej ky mbetet tregu kryesor, meqë ende mbetet të bëhet shumë punë që të krijohen produkte cilësore. Dobësitë e monostrukturës i rrit edhe fakti se hotelet janë ndërtuar sipas kriterëve impersonale të funksionimit.

Momentalisht kërkesat turistike në Kosovë janë të lidhura me mysafirët vendës dhe të huaj.

Vendet fqinje, dhe ato nga rajoni që janë në procesin e transformimit, mund të bëhen të rëndësishme në të ardhmen. Grupi më i madh i turistëve me të ardhura të vogla në ato vende momentalisht nuk mund t'i marrim në konsideratë për shkak të infrastrukturës së dobët të rrjetit rrugor dhe udhëtimit të gjatë me automjete. Paket çarter ata me siguri nuk i paguajnë dot. Ata që kanë mundësi më të madhe pagese kërkojnë destinacione më ekskluzive.

Numri i shtretërve ka rënë nga 8.000 në rreth 6.000. Nuk ekzistojnë më tregjet e ish-Jugosllavisë. Kërkesat lidhen vetëm me vizitorë që zyrtarisht vizitojnë Kosovën ose shkojnë nga Kosova.

Të ardhurat e ulëta, plotësimi i dobët dhe gjendja që nuk u përgjigjet mysafirëve me kërkesa më të mëdha, janë karakteristikë e hoteleve. Vetëm rreth 1.000 shtretër hotelesh janë të përshtatshëm për ofertë në tregun e jashtëm. Mbi këtë bazë nuk mund të krijohet ekonomia e përparuar turistike, sidomos jo në turizëm modern.

Nga atraktiviteti dhe konkurrenca e ekonomisë turistike kosovare varen vendet e punës dhe mirëqenia, jo vetëm e një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, por edhe përparimi i fuqisë ekonomike të vendit në përgjithësi. Tani ekonomia turistike e Kosovës gjendet në një situatë tepër të vështirë, sepse:

- hotelet e sektorit shoqëror që kanë rreth 70% të shtretërve në Kosovë janë të vjetër, në gjendje të keqe dhe të pajisur jo mirë,
- kanë qenë, por edhe tani janë të orientuar në turizmin transit dhe afarist që ka për bazë çmimet,
- Është i vogël numri i mysafirëve në hotelet në pronësi shoqërore (objektet për kohën e lirë, alternativat gastronomike etj.),
- as më heret e as tani Kosova nuk e ka ndërtuar imixhin e saj turistik,
- shitja efikase vendore është pak ose aspak e pranishme si instrument marketingu ose KNOË-HOË,
- Menaxhmenti i hoteleve nuk orientohet as në konkurrencë e as në ekonominë e tregut dhe nuk ka sisteme moderne komunikacioni dhe informacioni.

*Kësaj mund t'i shtohen edhe këto probleme:*

- Organizimi dhe udhëheqja e dobët e politikës turistike në nivel kombëtar,
- Lidhshmëria e dobët e ofertës turistike (mungesa e produktit atraktiv turistik),
- Mungesa e një strategjie të zhvillimit afatgjatë shoqëroro-ekonomik,
- Mungesa e planit hapësinor të Kosovës,
- Aftësimi i dobët i kuadrit menaxhues dhe moszhvillimi i sistemit menaxhues në ndërmarrjet turistike dhe hoteliere të Kosovës,
- Problemet me energjinë, ujin dhe kanalizimin e ujërave të zeza dhe hedhurinat,
- Shkatërrimi i natyrës dhe i qendrave urbane nga ndërtimi ilegal,
- Mungesa e kanaleve të shitjes dhe kooperimi i ofertuesve,
- “Tregu i zi”
- Interesimi i dobët i investitorëve për shkak të moszgjidhjes së pronësisë mbi tokën, benificionëve për investime dhe kategorizimit.

### **Ekonominë turistike të Kosovës e karakterizojnë edhe faktorë që e ngarkojnë përshtatshmërinë për treg:**

- Imixhi i vendit është dobësuar për shkak të luftës, të pasojave të luftës dhe nivelit të shërbimeve,
- Hotelet jo vetëm janë planifikuar si “produkt industrial uniform”, por nuk i janë përshtatur zhvillimit të tregut, mesatarisht janë ndërtuar 20-30 vjet më parë. Një pjesë e tyre nuk kanë funksionuar, sepse janë zënë nga KFOR-i dhe UNMIK-u,
- Rentabiliteti i hoteleve është kërcënuar. Vetëm pak hotele janë në gjendje të bëjnë investime me mjetet e veta,
- Investimet private një gjeneratë të tërë i janë lejuar vetëm në një vëllim të vogël. Mungojnë përvojat dhe traditat për punë zyrtare turistike. Fuqia e kualifikuar punëtore ka shkuar,
- Tregu jugosllav ka humbur në këto 10-15 vjet. Tregu vendor është i vogël. Tregu i Shqipërisë dhe i Maqedonisë nuk është i fortë nga aspekti financiar,
- Sado të jenë të pastërta nga brenda, pamja e jashtme e hoteleve është prishur nga deponitë e egra të hedhurinave dhe mosrregullimit të duhur të kanalizimit të ujrave të zeza si dhe nga ndërtimi i pakontrolluar.

### **Synimet dhe masat strategjike që duhet të merren janë:**

Kosova ende nuk e ka strategjinë e zhvillimit shoqëroro-ekonomik, ndërsa strategjia e zhvillimit të turizmit është e vitit 1975. Si rezultat i kësaj, rrjedhat turistike zhvillohen në mënyrë stihike dhe vullunteriste.

### **Synimet themelore të zhvillimit të ekonomisë turistike janë:**

- Përtëritja, revalorizimi i plotë, mbrojtja e potencialeve turistike dhe krijimi i imixhit të ri turistik,
- Ristrukturimi dhe modernizimi i ofertës së gjithmbarshme turistike,
- Përzgjedhja dhe nxitja e zhvillimit të turizmit sipas kritereve të hapësirave në dispozicion dhe cilësisë së tyre si resurse bartëse natyrore,

- Themelimi i standardeve ekologjike që do të mundësojnë mbrojtjen efikase të resurseve natyrore,
- Nxitja e zhvillimit të rajoneve turistike me mundësi më të volitshme për zgjatjen maksimale të sezonit turistik dhe rritja e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve të ofertës turistike,
- Renovimi i hoteleve dhe ngritja e standardit të tyre,
- Objektet me vlerë më të vogël në lokacionet e jashtëzakonshme të zëvendësohen me objekte me cilësi të lartë,
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme (përmbajtjet rekreative),
- Sigurimi i potenciali ndërtimor (trojet).

***Në afat të shkurtër propozohen këto masa:***

- Shpejtimi i privatizimit të hoteleve me ndihmën e një eksperti që ka përvojë ndërkombëtare për kategorizimin e tyre,
- Krijimi i imixhit vetjak me ndihmën e firmës ndërkombëtare,
- Lehtësimi i kalimit të kufirit (lidhjet rrugore përmes kufirit, kartoni i gjelbër),
- Pengimi i spekulimeve me tokën dhe i “tregut të zi”,
- Parandalimi i ndërtimit të pakontrolluar, të egër,
- Lejet për objektet e reja vetëm duke promovuar kërkesat ose ofertën e tipit të ri,
- konsolidimi i zhvillimit komunal në një Masterplan,
- Krijimi i sistemit të informimit, mënyra e shitjes....
- Lidhja e kontratave për menaxhimin e zingjirit global hotelier ,
- Shkollimi i menaxherëve të hoteleve dhe zbatimi i metodave ndërkombëtare në udhëheqjen e hoteleve (menaxhimi financiar, Uniformsistem),
- Kooperimi me turoperatorë.

## **POTENCIALET TURISTIKE DHE KONCEPTI THEMELOR I HIERARKISË SË OFERTËS**

Resursi strategjik i turizmit kosovar duhet të mbetet hapësira me shumë vlerë, deri tani e ruajtur, që në afat të gjatë gjithnjë e me shumë do të ketë rëndësi.

Vlera turistike kanë pothuaj të gjitha trevat e Kosovës në format dhe dimensionet, varësisht nga resurset dhe shkalla e zhvillimit.

Fizionomia e elementeve tërheqës të Kosovës udhëzon qartë në rajonet malore, drejtimet e transitit turistik, qytetet e mëdha, banjat, komplekset dhe pasuritë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, lokalitetet e gjuetisë dhe fshatrat.

Duke u nisur nga trendet aktuale dhe trendet e parashikuara të kërkesës ndërkombëtare turistike, mundësi reale në plasimin e ofertës turistike në tregjet ndërkombëtare mund të priten në qendrat rajonale të Kosovës në malet e larta, në drejtimet e transitit ndërkombëtar rrugor, në komplekset e trashëgimisë natyrore dhe kulturore me vlerë shumë të madhe dhe në vendet më të rëndësishme të gjuetisë. Kërkesa vendore turistike edhe më tej do të realizohet në qytetet e mëdha të Kosovës dhe në banja, por pritet edhe pjesëmarrja në rritje e kërkesave për turizmin malor, fshatar dhe për turizëm në rajonet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Ne etapën e parë të zhvillimit të turizmit theksi do të vihet në koncentrimin e ofertës së vendosur mirë për pjesën kryesore të kërkesës turistike ,ashtu që pjesa më e madhe e kapaciteteve të gjenden shumë afër atyre që deshirojnë të gjenden në natyrë ,të zhvillojnë alpinizëm ,të merren me gjueti dhe peshkim ,të kënaqen me vlerat kulturore si në sezonin veror dhe ate



dimëror. Që këtej rrjedh edhe konkluzioni se kapacitetet e para të turizmit dimëror duhet të organizohen në rajonet malore dhe hapësirat e skijimit me shtrirjen shkallë - shkallë në vendet më të larta dhe në drejtim të krijimit të qendrave të mëdha dhe komplekse dimërore-turistike..

Në këtë mënyrë një oferte e tillë mund të kënaq klientelën e shumëllojshme në kuadër të turizmit popullor dhe pas afirmimit, më vonë do të rritej aktiviteti në tregjet më ekskluzive dhe më të ndjeshme, por me një rrezik më të vogël në investime.

Meqë mundësitë hapësinore të Kosovës janë shumëfish më të mëdha së fuqia e tregut turistik dhe shoqëror –ekonomik dhe e valorizimit në këte periudhë të planit janë rezervuar edhe ato vlera natyrore që në treg do të paraqiten më vonë.

### **Tri nivelet e ndryshme që krijojnë hierarkinë e ofertës turistike të Kosovës:**

**1. Niveli i parë** –oferta kulminante turistike e Kosovës që përfshinë rrethin më të gjerë të kërkesës lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare:

- Peizazhet masive malore të Bjeshkëve të Nemuna ,që kanë kapacitet të madh pranimi, natyra e ruajtur ,sidomos flora pyjore dhe fauna ,
- Lartësitë malore që arrijnë mbi 2600 m me kushte të përshtatshme klimatike për zhvillimin e turizmit veror e sidomos të atij dimëror ;
- Rrjeti i qyteteve dhe vendbanimeve me ofertën e organizuar të serviseve shërbyese që lidhen me korridoret kryesore të komunikacionit ,si sistem
- Hapësinor i zhvillimit të qarkullimit dinamik (qendrat kryesore: Prishtina, Prizreni dhe Peja).

**2. Niveli i dytë** – oferta turistike kosovare me rëndësi dhe një rreth i ngusht ndërkombëtar (Kosova, rajonet kufitare të Shqipërisë, Serbisë, Malit të Zi ,dhe Maqedonisë).

- Masivet malore të Kopaonikut dhe Mokra Gorës si hapësira jashtëzakonisht cilësore për turizëm gjatë gjithë vitit (kanë rëndësi sekondare kryesisht për shkak të faktit se në të njëjtin rajon gjenden Bjeshkët e Nemuna dhe Sharri),
- Qendrat termale: Ilixha (Banja e Pejës ), Kllokoti (afër Gjilanit ) dhe Banjska (afër Mitrovicës).
- Sistemi i atraksioneve natyrore me bukuri të veçantë si Kanioni dhe Ujëvarat e Mirushës, kanioni i Rugovës ,Burimi i Drinit të Bardhë, Bigëzimi i Nerodimes, Shpella e Mermerit dhe e Radavcit etj.
- Pasuria, shumëllojshmëria etnike dhe kulturore por edhe tërësitë e Ruajtura kulturore historike dhe monumentet e veçanta, midis të cilëve ka të tillë që janë atraksione unike për një klientelë të caktuar.

**3. Niveli i tretë** – është oferta turistike e ekskursioneve ditore dhe të fundjavës pranë qendrave urbane, në bazë të elementeve ekzistuese natyrore që ka si qëllim rekreacionin dhe pushimin e vazhdueshëm të banorëve.

Përveç vendosjes së hierarkisë së niveleve të ofertës turistike është bërë edhe rajonizimi i hapësirës turistike të Kosovës, në bazë të tërësisë teknologjike dhe të tregut të rajoneve të caktuara, si:

**1. Rajoni qendror turistik i Prishtinës** është epiqendra e të gjitha ecurive turistike të Kosovës (komuna e Prishtinës, Besiana, Drenasi, Lypjani, Kastrioti dhe Fushë- Kosova ). Edhe pse turizmi këtu nuk paraqet ndonjë

drejtim të theksuar të zhvillimit, llogaritjet në ecurinë e rëndësishme të turizmit transit dhe afarist, në bazë të sistemit të qarkullimit, të monumenteve të rëndësishme të trashëgimisë historike dhe tërheqjes së qendrës së zhvilluar qytetare me shërbimet e nivelit më të lartë në Kosovë .

**2. Rajoni turistik i Bjeshkët e Nemuna** është hapësira kapitale për zhvillimin e turizmit (komunat Pejë, Deçan, Burim, Klinë, Gjakovë dhe Rahovec. Qendra kryesore është Peja ndërsa nënqendrat Deçani dhe Gjakova.

Bjeshkët e Nemuna janë rajoni potencialisht më i rëndësishëm turistik i Kosovës. Hapësirat natyrore jashtëzakonisht cilësore ,mundësitë e mëdha të pranimit të vizitorëve dhe monumentet kulturore-turistike krijojnë mundësi të pakufizuara të zhvillimit turistik . Ndër vlerat me të rëndësishme duhet të theksojmë vetë masivin malor të Bjeshkët e Nemuna dhe të Moknës (si degë e ndarë),fushat dhe kanionet e Drinit të Bardhë ,të Bistricës së Pejës dhe të Deçanit , të Erenikut dhe të Mirushës ,të liqeneve malore , qytetet si Peja, Deçani dhe Gjakova ,Burimet Termale dhe rrjeti i mirë rrugor .

Rajoni turistik i Bjeshkëve të Nemuna ka karakter policentrik, si i tillë prandaj edhe do të zhvillohet në të ardhmen.

Peja është qendra me e shquar turistike e rajonit, por edhe e gjithë Kosovës dhe edhe me tej do të mbajë këtë vend. Por këtu janë edhe qytetet e Deçanit dhe Gjakovës si dhe qendrat komunale të Rahovecit, të Klinës dhe Burimit (jashtë orientimeve të drejtpërdrejta të rrjedhave turistike ,por në lidhje të ngushtë me hapësirat kryesore turistike të rajonit) Peja, Deçani dhe Gjakova do të jenë pikënisje të vajtjes deri të kapacitetet turistike malore,duke koncentruar të gjithë veprimtaritë përcjellëse të serviseve dhe të tjera .

Vet rajoni i Bjeshkëve të Nemuna do të shfrytëzohet për organizimin e ofertës së tërësishme turistike me një afarizëm gjatë gjithë vitit (sidomos në sezonin e verës dhe të dimrit). Veç zhvillimit të të gjitha llojeve të sporteve dimërore në lartësi mbi 1.000 m. ofrojnë mundësi ideale për turizmin veror malor (ecja, alpinizmi) si dhe zhvillimi i turizmit shëndetësor.

Rajoni malor turistik i Bjeshkëve të Nemuna është rajon më i madh turistik se rajoni i Sharrit. Prandaj këtu ekzistojnë kushtet për formimin e disa zonave (zona e tashme e Deçanit dhe e Pejës )që do të bashkonin qendrat malore të Rusolisë, Kurvalës, Bogdashit, Kopaonikut, Bjeshkës se Belegut ,etj nga Gjeravica në jug, deri te Mokna dhe Hajla në veri .

Për nga fizionomia e tyre Bjeshkët e Nemuna mund të klasifikohen në rajonet natyrore potenciale malore turistike që ofrojnë mundësi për formimin e ofertave komplete turistike që mbështeten në potencialin e jashtëzakonshëm atraktiv të masivit malor.

Sipas specifikave dhe karakteristikave natyrore, sidomos sipas veçorive të relievit, të shumëllojshmërisë biogeografike të resurseve jashtëzakonisht të pasura ujore, të pasurisë së peizazheve dhe të motiveve të mjedisit, Bjeshkët e Nemuna, pa dyshim, janë masivi me unik malor në Ballkanin Perëndimor. Bjeshkët e Nemuna kanë vlerë kulmore në:

- Pasurinë, shpeshësinë, shumëllojshmërinë dhe veçantitë gjeomorfologjike të objekteve (malet, grykat, kanjonet, shpellat, etj dhe veçorit e tyre atraktive),
- Kushtet morfologjike për zhvillimin e sporteve dimërore ,të alpinizmit dhe të speloturizmit,
- Denivelimin dhe kapacitetet potenciale, të shtigjeve të skijimit (65.396m dhe po aq skiatorë në një orë), me hapësira dhe kushte të tjera për zhvillimin e turizmit sportivo- dimëror.

Si dukuri sidomos impresive gjeomorfologjike me atribute shumë të dukshme estetike dhe që ngjallin kuriozitet dallohen:

Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Ujëvara e Mirushës, Shpella e Radavcit, kreshtat shkëmbore, Maja e Koparunikut. Hapësira e Bjeshkëve të Nemuna paraqet vlerë të veçantë turistike, por njëkohësisht është faktor i valorizimit të tërë natyrës turistike të Bjeshkëve të Nemuna.

**Ndarja në zona klimatike** (kryesisht kontinentale, subalpike dhe malore ndihmon në zhvillimin e turizmit dystinor (veror dhe dimëror) dhe mundëson shërimin klimaterik (me aeroterapi dhe hiloterapi) në lartësitë e ndryshme mbidetare.

Bjeshkët e Nemuna janë një banjë potenciale ajrore me mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit shëndetësor.

Këtu ekzistojnë kushte të përshtatshme jo vetëm klimatike, por edhe fiziko-geografike (komplekset e giera të pyjeve dhe të livadheve, pasuria hidrografike, bukuritë natyrore etj.) ku mund të ndërtohen sanatoriume, qendra kurimi, rekreacioni dhe qendra për përgatitjen e sportistëve në lartësitë mbidetare.

Janë të rralla malet që kanë një pasuri aq të madhe me një faunë interesante si Bjeshkët e Nemuna.

Kjo faunë (ariu i murrmë ,derri i egër,dhia e egër ,pulegra e madhe etj.) që kanë vlerë të madhe trofeu.

Vendet e gjuetisë në Bjeshkët e Nemuna janë mjaft atraktive, por duhet të rregullohen teknikisht dhe të mbrohen, në mënyrë që të përfshihen më me sukses në zhvillimin e turizmit të gjuetisë.

Rajoni i Pejës, i Deçanit dhe i Ibrit janë përplot me lloje të rëndësishme peshqish që krahas bukurisë së peizazhit, ofrojnë kushte të jashtëzakonshme për zhvillimin e **turizmit të peshkimit**.

Nga vlerat dhe **atraksionet antropogjene turistike** që përbëjnë njërin nga komponentët më atraktive të ofertës turistike të Bjeshkëve të Nemuna mund të veçojmë:

- Trashëgimia e pasur dhe e shumëllojshme e monumenteve (zbulimet parahistorike), kishat mesjetare serbe, monumentet e arkitekturës islame (xhamitë, hamamet, urat dhe hanet),
- Pasuria etnografike dhe folklorike (veshja rugovase, vallet dhe këngët folklorike, zakonet tradicionale etj.),
- Motivët interesante të mjedisit dhe peizazhet (Çarshia e Gjakovës, Çarshia e Madhe e Pejës, vendbanimet fshatare, kullat, stanet në bjeshkë etj.),
- Veçoritë e tjera kulturo-historike të traditës dhe veçantitë e tjera.

#### **Komponente të rëndësishme për valorizimin e Bjeshkëve të Nemuna janë:**

- Objektet e mbrojtura të natyrës (të tashmet dhe të mundshmet), mjedisi jetësor ekologjikisht i shëndoshë dhe i paurbanizuar, largësia nga zhurma, popullimi i pakët dhe gjerësia e sipërfaqeve të lira për rekreacion në natyrë. Prandaj, ndërtimet e ardhshme nuk duhet t'i shkatërrojnë vlerat natyrore dhe të peizazheve, vlerat e mjedisit dhe as veçoritë autoktone të këtijë rajoni.
- Vlerat natyrore, sidomos ato të mjedisit, të peizazhit dhe vlerat estetike të Bjeshkëve të Nemuna, nga pikëpamja e veçorive të tyre, veçantive , karakterit burimor, shumëllojshmërisë dhe rarisë, meritojnë statusin dhe trajtimin e pasurive me interes të veçantë, prandaj duhet t'i mbrojmë edhe për brezat e ardhshëm në formën e parkut kombëtar.
- Nevoja e shpalljes sa më të shpejtë të **Bjeshkët e Nemuna park Kombëtar**, buron nga fakti se dekadave të fundit seriozisht janë rrezikuar dhe i janë nënshtruar shkatërrimit dhe degradimit e devastimit të pamëshirshëm.

Duke pasur parasysh strukturën e produkteve turistike dhe tendencat dhe kërkesat e turizmit, në Bjeshkët e Nemuna mund të zhvillohen degë të shumta dhe të shumëllojshme të turizmit, si : turizmi dimëroro-sportiv, shëndetësor rekreativ, shëndetësoro-kurues, ekskursionist rekreativ, gjuetie, peshkimi, fshatar, alpinist, spelleturizëm, etj. Në pajtim me kërkesat ekologjike, përparësi duhet t'i epet zhvillimit të degëve selektive të turizmit, si: turizmit ekologjik, fshatar, gjuetisë dhe të peshkimit, turizmit shëndetësor, rekreativ, alpinizmit, etj.

### **Prioritetet**

Duke pasur parasysh se për formimin e një qendre malore bashkëkohore turistike me sezon aktive verore dhe dimërore duhet një kohë e gjatë dhe mjete të konsiderueshme investive si dhe përkrahja e strukturave qeveritare. Ndërtimi parashikohet të kryhet në disa etapa.

Investimet në fillim duhet orientuar në zhvillimin e lokaliteteve që lidhen më mirë me rrjete rrugore dhe kanë potencial të pasur resurcesh, ku duhet të respektohet parimi i koncentrimit të ndërtimeve turistike dhe të konceptit të marketingut.

Në procesin e ndërtimit dhe të organizimit të përmbajtjeve turistike malore një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes dhe përparimit të sistemit ekzistues ekologjik të Bjeshkëve të Nemuna. Çdo cenim i baraspeshës do të kishte pasoja negative në mundësitë e valorizimit turistik. **Prandaj, organizimi i parkut kombëtare në rajonin e Bjeshkët e Nemuna është një hap i rëndësishëm në shfrytëzimin e organizuar optimal të mundësive potenciale të këtij rajoni.**

Destinimi dhe funksioni i Bjeshkëve të Nemuna duhet jo vetëm të përcaktohet në kuadër të Kosovës, por edhe brenda kësaj zone duhet të përcaktohen sektorët dhe lokalitetet në të cilat turizmi do të jetë funksioni ose njeri nga funksionet më të rëndësishme të zhvillimit. Kështu duhet të ndahen sektorët e shfrytëzimit primar ose sekondar turistik.

Dihet që turizmi, falë funksionit të tij ekonomik, shfaqet si katalizator i rëndësishëm hapësinor i veprimtarive ekonomike si dhe një nga faktorët e rrallë të integritetit rajonal.

Bjeshkët e Nemuna janë territor mjaft i dezintegruar dhe heterogjen. Që të realizohet roli i lartpërmendur i turizmit në këtë territor, është i domosdoshëm harmonizimi i planeve ekonomike, mjedisore urbanistike dhe turistike të zhvillimit ndërmjet njësive të përmendura administrative ku bëjnë pjesë Bjeshkët e Nemuna.

**Në një të ardhme të afërt këto plane duhet të harmonizohen me planet e zhvillimit të turizmit të Bjeshkëve të Nemuna që u takojnë Shqipërisë dhe Malit të Zi.**

**Në procedurën e klasifikimit të zonave dhe lokaliteteve turistike duhet t'i kenë parasysh kushtet dhe kriteret e caktuara, si:**

- Karakteristikat morfologjike ,
- Pozita ,shpeshësia dhe rendi i resurseve turistike ,
- Mundësia e zhvillimit të turizmit dysezonësh ,
- Lidhjet rrugore ,
- Mundësia e furnizimit me ujë dhe energji elektrike,
- Elementet estetike,
- Kërkesat ekologjike,
- Atraksionet plotësuese.

Zonat dhe lokalitetet turistike si dhe vendet e shfrytëzimit primar dhe sekondar turistik, janë klasifikuar në bazë të resurseve që kanë, kushteve, dhe kritereve të lartpërmendura. Në klasifikimin e lokaliteteve dhe të qendrave turistike, si faktor vendimtar është marrë prania e një vlere të veçantë ose, më së paku, tri deri në katër vlera komplementare turistike .

Në kuadër të Bjeshkëve të Nemuna, sipas pasurisë dhe shumëllojshmërisë së potencialit të resurseve, mund të dallohen këto zona turistike

- **Zona Pejë-Burim (Istog) dhe zona e Deçanit.**

**Pjesa e Pejës** e Bjeshkëve të Nemuna mund të identifikohen në shumë lokalitete ekzistuese: Koprniku, Rusolia, Zhlebi, Maja e Neqinës, Radavci etj. Meqë Peja është afër, aktivizimi i Koprnikut parashikohet në fazën e parë të zhvillimit të turizmit dimëroro –sportiv në rajonin e Pejës.

Falë afërsisë së Pejës terrenet e skijimit në Kopernik janë studiuar hollësisht.

**Pjesa e Deçanit** e Bjeshkëve të Nemuna, duke pasur parasysh shpërndarjen, strukturën dhe veçoritë cilësore-sasiore të resurseve turistike, mund të veçohen këto qendra dhe lokalitete:

Deçani, (qendra kryesore e turizmit veror), Kurvala, Bjeshkët e Belegut, Maja e Strellcit, Roshkodoli, Kozhnjeri, Gjeravica.

Te gjitha këto lokalitete futen në zonën primare të shfrytëzimit turistik, por aktivizimi i tyre do të bëhet radhazi (nga vendet ku mund të shkohet më lehtë në ato më të vështira).

Lokalitetet si Koprniku, Rusolia, Shtedimi dhe Bjeshka e Belegut me pozitën e tyre, tërësinë e denivelizimeve dhe potencialin cilësor të terreneve të skijimit (të shtigjeve ), kanë të gjitha elementet që të zhvillohen si qendra kryesore të turizmit dimëroro-sportiv në Bjeshkët e Nemuna.

**3. Rajoni Turistik i Sharrit** përfshinë masivin malor si tërësinë më të dallueshme dhe më të gjërë të kësaj pjese të Kosovës. Në këto zona bëjnë pjesë komunat: Prizreni, Shtërpca, Dragashi, Kaçaniku dhe Theranda. Siç kemi theksuar, zona turistike e Sharrit, krahas Bjeshkëve të Nemuna, është rajoni më atraktiv i Kosovës ku shtrihen hapësira natyrore me fuqi të madhe pranimit të turistëve dhe ka shkallë të lartë të ruajtjes së natyrës, e plotësuar me shumë elemente me origjinë shoqërore, pastaj në këtë zone gjendet fushat dhe kanionet e Drinit të Bardhë, të Bisticës së Prizrenit, të Lepencit dhe të degëve të tyre, qytetet si Prizreni dhe Ferizaj, komunat malore fshatare si Gora, Opoja, Sredska dhe Siriniçi si dhe korridoret e komunikacionit me pajisjet përkatëse dhe shërbimet përcjellëse.

Meqë Sharri gjendet pranë Bjeshkëve të Nemuna, duhet të jetë shembulli i parë i një modeli funksional turistik i Kosovës, si një nga zonat që duhet të kenë përparësi në ofertën turistike në tregun vendor dhe të huaj.

Karakteristika kryesore e ofertës së tashme dhe të planifikuar turistike të kësaj zone qendrore në zhvillimin dhe përparimin e njëkohshëm të dy formave themelore të veprimtarive turistike:

- Të turizmin transit dhe të motorizuar, dhe
- Të turizmit stacionar (ferial), sidomos në sezonin primar (veror dhe sezonin sekondare dimëror ).

Me ndërtimin e rrjetit përkatës rrugor, rrjedhat kryesore turistike shkojnë nëpër unazën primare rrugore, Gjakovë-Prizren-Sharr-Dragash që vazhdon drejt Prishtinës ose Shkupit. Ky rrjet komunikacioni duhet të pajiset me të gjithë serviset e nevojshëm, (motele, stacione servisi e karburantesh, parkingje, përmbajtje argëtuese, autokampe, rrugë deri te vlerat natyrore dhe historike, etj.)

Zona turistike e Sharrit nuk është monocentrike, sepse krahas Prizrenit, si qyteti më tërheqës turistik, kemi edhe Ferizajn (që ka pozitë të përshtatshme

komunikacioni), pastaj Dragashin, Therandën dhe Kaçanikun. Në pajtim me pozitën e vet në hierarkinë e mjediseve turistike, të gjitha vendet që përmendëm më lart do të jenë pika nistore në shfrytëzimin e kapaciteteve stacionare turistike dhe të përmbajtjeve të tjera të planifikuara.

Është fakt se mundësitë për të pranuar turistë janë shumë më të mëdha se sa ofertat reale të parashikuara deri në vitin 2014, çka do të thotë që planifikimi duhet të kuptohet si proces në vazhdim, me etapa, realizimi i të cilave do të varet nga shkalla e arritur e zhvillimit shoqëroro-ekonomik.

Oferta e planifikuar turistike e ka burimin në nevojën e plotësimit të segmenteve të ndryshëm të kërkesave turistike gjatë gjithë vitit (sidomos në sezonin veror dhe dimëror), me këto aktivitete:

Sportet dimërore, alpinizëm, gjueti, peshkim, turizëm shëndetësor.

**Zona e Sharrit** (nga Luboteni në verilindje deri te Brodi në jug-perëndim) ndahet në tre sektorë kryesorë:

1. Sektori i Lubetenit dhe Brezovicës,
2. Sektori i mesëm rreth rrugës Prizren-Tetovë dhe
3. Sektori i Brodit.

Brenda këtyre tre sektorëve kryesorë planifikohen sistemet e qendrave turistike, ndërsa në pajtim me parimin e ndërtimit të koncentruar hapësirat e ndërmjetme krijojnë mundësinë e shijimit të natyrës së paprekur dhe ekskursione ditore të vizitorëve. Kjo do të mundësojë që të krijohen lidhje funksionale dhe hapësinore me sistemet e planifikuara turistike në anën Maqedone (Vratnica, Popova, Shapka, Mavrova).

Si rajone plotësuese të ekspansionit të mëvonshëm turistik parashikohen masivet e Koritnikut dhe të Pashtrikut, ndërsa për nevojat e popullsisë lokale do të organizohet oferta përkatëse e kapaciteteve turistike-ekskursioniste.

Qendrat e planifikuara turistike do të organizohen si njësi të pavarura themelore të ofertës turistike që do të plotësojnë të gjitha nevojat për bujtje, argëtim, rekreacion dhe veprimtari të tjera.

Përparësitë kryesore të një ndërtimi të tillë do të jenë këto:

- Mënyra e vetme e ruajtjes së vlerave natyrore dhe shoqërore në rajon,
- Vendosja e një shkalle të dëshirueshme të jetës shoqërore që rritë mundësitë e rekreacionit dhe është mënyra më e përshtatshme e organizimit të të gjithë elementeve të ofertës turistike,
- Arritja e rezultateve të kënaqëshme ekonomike në ndërtim dhe afarizmin e mëtejshëm,
- Zgjidhja më e lehtë e problemit akut të kualifikimit të fuqisë punëtore.

Në rajonin e Sharrit është planifikuar organizimi i dy sistemeve turistike, ai i Brezovicës dhe i Dragashit dhe që tani ka filluar procesi i zhvillimit turistik, ndërsa situatë reale e komunikacionit rrugor sugjeron marrjen e vendimit që në rajonin e Brezovicës të fillojë ndërtimi dhe organizimi i sistemit të parë të madh të ofertës turistike. Duke pasur parasysh ofertën e planifikuar turistike në Kosovë si tërësi, duhet të theksojmë se deri në fund të periudhës së planifikimit (viti 2014) në rajonin e Sharrit, përveç këtij sistemi, nuk planifikohen kapacitete të tjera të rëndësishme.

**4. Rajoni turistik i Kopaonikut** gjendet në qendër të shkallës turistike të Kosovës, dhe ka elemente shumë cilësore që megjithatë janë relativisht më të dobët se të Sharrit dhe të Bjeshkëve të Nemuna (komunat Mitrovica, Zubin- Potoku, Leposaviqi, Skenderaj dhe Vushtrria).

Këtu kryesisht pritet zhvillimi i turizmit transit dhe afarist e më vonë edhe të turizmit bujtinar në Kopaonik dhe Makna-Gorë. Qendër e rajonit është Mitrovica.

**5. Rajoni Turistik i Moravës së Epërme** më pak i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në Kosovë, sepse nuk ka vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe shoqërore dhe gjendet jashtë rrjedhave kryesore turistike.

## Turizmi shëndetësor

Turizmi shëndetësor paraqet një segment të rëndësishëm të ofertës së tashme turistike kosovare.

Banjat janë qendra shëndetësore-rekreative dhe turistike me ofertë të veçantë dhe me ofertë në kuadër të rajoneve dhe drejtimeve transite-turistike. Banjat e Kosovës kërkojnë një rilindje thelbësore dhe përmirësimin e ofertës.

### Synimet zhvillimore të turizmit shëndetësor në periudhën 2004 – 2014 janë:

- Përtëritja dhe rivitalizimi i komplekseve shëndetësore të Ilixhës dhe Banjës së Kllokotit
- Rritja e kapaciteteve hoteliere në banja të lartpërmendura.

Radhitja e banjave

- Banjat e shkallës së parë janë Ilixha dhe Kllokoti,
- Ndërsa të rendit të dytë Banjska dhe banjat tjera.

## Turizmi tranzit

Drejtimet transite turistike janë të veçanta, janë hapësira specifike të ofertës turistike përgjatë korridoreve të rëndësishme të rrugëve vendore dhe ndërkombëtare, si në kuadër të rajoneve turistike, gjithashtu edhe si ofertë e veçantë. Sipas rëndësisë radhitën në drejtime rrugore turistike të shkallës së I dhe të II-të

Për zhvillimin e qarkullimit të turizmit turistik, rëndësi të veçantë kanë këto rrugë:

- Prishtinë-Prizren-Kukës-Durrës,
- Prishtinë-Mitrovicë-Beograd,
- Prishtinë-Shkup,
- Prishtinë-Gjilan-Bujanoc,
- Prishtinë –Medvegjë-Leskoc,
- Prishtinë-Prizren-Pejë-Rozhajë,
- Prishtinë-Doganaj-Tetovë,

### Përparësi në pajisje duhet t'u jepet rrugëve:

- Rruga e Ibrit nga Prishtina në Mitrovicë deri në Beograd,
- Prishtinë – Shkup,
- Prishtinë – Prizren – Pejë - Rozhajë,
- Prishtinë - Doganaj-Tetovë,
- Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë,
- Prishtinë-Shtërpçë-Prizren
-

**Përparësi ndërtimi të rrugëve të reja kanë rrugët:**

- Prishtinë-Prizren-Kukës-Durrës,
- Deçan – Plavë,
- Dragash – Tetovë.

**Transporti hekurudhor**

Pa hyrë në problemet që aktualisht ka transporti hekurudhorë, për shkak të ngadalësisë së udhëtimit, shprehive të udhëtimit dhe të mungesave cilësore, nuk ka ndonjë rëndësi të madhe për turizmin vendor dhe ndërkombëtar në Kosovë, bile edhe në zhvillimin afatmesëm do të ketë funksion të dorës së dytë.

**Transporti ajror**

Aeroportet kanë rëndësi qendrore për zhvillimin e turizmit cilësorë. Në turizmin Mesdhetar nga Evropa Perëndimore udhëtimet çarter nga Evropa Perëndimore për Kosovë mund të rritet vetëm pasi të ndërtohen qendrat reja turistike dhe pasi të krijohet produkti cilësorë turistik.

Aeroporti I Prishtinës teknikisht kryesisht I përgjigjet kërkesave kryesore, por nga aspekti turistik ekzistojnë deficite të konsiderueshme, sidomos ato që lidhen me nivelin dhe cilësinë e servisit.

Momentalisht aeroporti I Prishtinës operon me tetë linja ajrore me orar dhe shtatë bartëse çarter ajrorë.

Në Aeroportin e Prishtinës në afat sa më të shkurtër duhet:

- Të kryhen punët rreth licencimit dhe certifikimit sipas standardeve të ICAO- s ( Agjencia rregullative e OKB- së për Aviacionin civil ).
- Të aftësohet Aeroporti I Gjakovës si aeroport rajonal, civil dhe si aeroport alternativ I atij të Prishtinës.

**Qendra Turistike Qytetare**

Qendrat qytetare turistike janë qytetet me ofertë të veçantë turistike ose me ofertë në kuadër të rajoneve dhe të drejtimeve transite turistike. Renditen në qendra të shkallës së I , II dhe të III-të.

**Qendër e shkallës së I-rë :**

- Prishtina.

**Qendra të shkallës së II janë :**

- Peja
- Prizreni
- Gjakova
- Gjilani
- Mitrovica
- Ferizaj

**Qendra të shkallës së III janë:**

- Besiana
- Vushtrria
- Theranda
- Lipjani
- Deçani
- Dragashi
- Leposaviqi
- Drenasi



- Vitia
- Burimi
- Rahoveci
- Kaçaniku
- Skenderaj
- Dardana
- Klina

### Llojet prioritare të produktit turistik sipas rajoneve turistike

1. Rajoni Qendror Turistik i Prishtinës
  - Turizmi afarist
  - Turizmi kongresal
  - Turizmi kulturor
  - Turizmi transit
2. Rajoni turistik i Bjeshkët e Nemuna
  - Turizmi malor
  - Turizmi dimëroro-rekreativ
  - Turizmi rural
  - Gjuetia dhe peshkimi
  - Turizmi shëndetësor
  - Turizmi tranzitor
  - Shëndetësor – kurativ
  - Ekskursionist – rekreativ
  - Turizmi alpinist
  - Speleoturizmi
3. Rajoni turistik i Sharrit
  - Turizmi malor
  - Turizmi dimroro-rekreativ
  - Turizmi rural
  - Gjuetia dhe peshkimi
  - Aktivitetet në natyrë
  - Turizmi alpinist
  - Ekskursionet-rekreative
4. Rajoni turistik i Anamoravës
  - Turizmi shëndetësor
  - Turizmi tranzitor
5. Rajoni turistik i Kopaonikut
  - Turizmi malor
  - Turizmi rural
  - turizmi shëndetësor

## MASAT NË FUSHËN E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Planifikimi cilësor i hapësirës është ndër parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të turizmit.

Hapësira , në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë, është parakushti themelor i ardhjes dhe i qëndrimit të mysafirëve e njëkohësisht është edhe faktor i zhvillimit të destinacionit dhe faktor aktiv që e kushtëzon. Ndërtimi i infrastrukturës turistike ka karakter afatgjatë, prandaj planifikimi integral i zhvillimit të hapësirës është kushti themelor i funksionimit të suksesshëm afatgjatë të destinimit turistik. Planet hapësinore janë njëri nga dokumentet themelore të zhvillimit të turizmit , sepse orientojnë dhe përcaktojnë planifikimin e të gjitha degëve dhe veprimtarive ekonomike që aktivisht marrin pjesë në formimin e ofertës turistike .

### Synimi:

- optimalizimi i zhvillimit turistik në kuadër të zhvillimit hapësinor të Kosovës ,
- Detyra e planifikimit hapësinor është baraspeshimi i shërbimeve bujtinor , qarkullimit , komunikacionit dhe shërbimeve të tjera duke mbrojtur resurset atraktive në të cilat bazohet zhvillimi turistik ,
- Zhvillimi turistik duhet të jetë në pajtim me kushtet e zhvillimit të qëndrueshëm .

### Aktivitetet:

- Definimi i shfrytëzimit të hapësirës për turizëm në nivel kombëtar,
- Zhvillimi i turizmit në Kosovë të mbështetet në planet hapësinore si dokumente kyçe juridike që turizmit i japin rolin e bazës zhvillimore dhe të drejtimit të zhvillimit të tërësishëm ekonomik që garantojnë administrimin më me përgjegjësi dhe më efikas të resurseve të destinimit turistik ,
- Në bazë të karakteristikave specifike natyrore dhe kulturore të rajoneve dhe të lokaliteteve duhet të përcaktohet lloji i turizmit që optimalisht do t'i shfrytëzojë resurset ekzistuese dhe të kushtëzojë atë ndërtim që është i mundshëm dhe i pranueshëm , varësisht nga karakteristikat kyçe të hapësirës.
- Gjatë ndërtimit të objekteve të reja, përkatësisht me rastin e projektimit të stilit të ndërtimit dhe të zgjedhjes së materialit, duhet të respektohen tradita dhe stili autokton i mjedisit rrethues që të ruhet harmonia dhe identiteti pamor i rajoneve të caktuara .

### Hapat themelor për shfrytëzimin përkatës të hapësirës

- Hartimi i Strategjisë së zhvillimit të turizmit për periudhën 2004-2014,
- Në një afat sa më të shkurtër të miratohet Plani hapësinor i zhvillimit të turizmit kosovar. Në Plan duhet të merren parasysh jo vetëm aspektet fizike, por edhe ato cilësore dhe logjistike të zhvillimit në destinacionet turistike;
- Hartimi i Masterplaneve – dokumente strategjike për të gjitha rajonet turistike të Kosovës, të cilët duhet të jenë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të

**Masterplani duhet të përmbajë:**

- Identifikimin dhe valorizimin e resurseve ekzistuese turistike,
- Përshkrimin e temave lokale dhe të karakteristikave të produktit turistik që duhet të zhvillohet (p.sh. turizmi malor, dimëroro-sportiv, termal, fshatar, etj.),
- Përshkrimin e infrastrukturës së nevojshme turistike ,bujtjes, logjistikës, distribuimit si dhe parimet thelbësore për caktimin e çmimeve të marketingut strategjik,
- Planin e aksionit për zbatimin e Masterplanit, përfshirë edhe burimin për financimin e programit, strukturën e nevojshme organizative lokale, proceset dhe veprimtarët e nevojshëm.

**Hartimi i planeve të hollësishëm urbanistik për:**

- Sistemin dimëror-rekreative “Bjeshka e Belegut” në Deçan,
- Qendrën dimërore-rekreative “Kopranik” në Pejë
- Qendrën dimërore-rekreative “Brodi” në Sharr
- Qendrën dimërore-rekreative “Kaçaniku”, dhe
- Qendrën dimërore-rekreative “Bogaj” në Pejë.

**Prioritet e zhvillimit të turizmit nga aspekti i rregullimit të hapësirës janë:**

- T’i jepet përparësi rikonstruktimit të hoteleve ekzistuese të sektorit shoqëror deri në nivelin e kërkesës evropiane,
- T’i jepet përparësi përmirësimit të infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme dhe mbrojtjes së mjedisit,
- Në qoftë se ndërtohen objekte të reja, përparësi t’i jepet ndërtimit në hapësira ku ka nevojë për sanimin e shumëllojshëm të terrenit dhe jo lokacionet më aktive. Objektet duhet t’i përshtaten mjedisit lokal,
- Në kuadër të analizës së ndërtimtarisë turistike të hapësirës kosovare menjëherë duhet të fillojë hartimi i një studimi të plotë dhe i bazës programore për llojet selektive të turizmit (gjuetisë, rural, ekoturizmit, turizmit kulturor, turizmit të kongreseve, turizmit rekreativ, etj.),
- Ndërtimi i kapaciteteve bujtinare për nevojat e parqeve kombëtare të orientohen në vendet anësore, jashtë kufirit të mbrojtjes.

**L I T E R A T U R A :**

A/ OECD ( ACAU- Atelier Cooperatif d’Arahitecture et d’Urbanisme)  
Geneve,më 1968:

- “Analiza e mundësive dhe problemeve të zhvillimit të turizmit dimëror-sportiv”
- Dr.I.L Aeschliman-“Analiza e tregut të huaj turistik të turizmit dimëror-sportiv në Jugosllavi”
- I.B.T. Trbovlje, “Programi i zhvillimit të turizmit dimëror-sportiv në Kosovë”,botimi (1972)

I.K.T.Zagreb më 1974

- “Programi i zhvillimit të turizmit në Bjeshkët e Nemuna”;
- “Programi i zhvillimit të turizmit ne masivin e Sharrit”;
- “Plani detal urbanistik i Brezovicës” ;
- “Plani gjeneral urbanistik i Bjeshkëve të Belegut”

B/.Kolë Staka

- “Raport vrojtimi mbi gjendjen dhe problemet e zhvillimit të turizmit në Kosovë”,nëntor 1999,
- “Vlerësimi i mundësive për investime në hotelerinë e Kosovës (rezime)”,nëntor 2000,
- “Informatë e shkurtër mbi resurset turistike të Kosovës, gjendjen aktuale të ekonomisë turistike të Kosovës dhe propozimi i listës prioritare për ndërtimin e objekteve hoteliere në Kosovë”,korrik 2001,
- “Gjendja dhe problemet e zhvillimit të turizmit në Kosovë”,prill 2002,
- “Analiza e shkaqeve dhe tendencave të pavolitshme në zhvillimin e turizmit në Kosovë në periudhën e pasluftës”, janar 2003.

C/. Enti i Statistikës i Kosovës:

- Vjetarët statistikorë 1969 – 1989,
- Direktariumi I bizneseve,dhjetor 2000,
- Pasqyrë statistikore mbi bizneset në Kosovë, nëtor 2002.

D/. Zyra e Regjistrimit të bizneseve pranë MTI-së, qershor 2004

## ZHVILLIMI I HAPËSINOR I TURIZMIT

